

ZHAN-KLOD FAVERIAL DHE MANASTIRI NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE

nga
Robert Elsie

Kur flasim për Manastirin dhe rëndësinë e tij në historinë e kulturës shqiptare, mendojmë në radhë të parë për Kongresin vendimtar të vitit 1908, i cili hodhi themelet e gjuhës letrare shqipe të sotme. Mendojme gjithashtu për veprimtarinë kulturore dhe fetare e familjes Qiriazi para një shekulli. Por Manastiri shquhet gjithashtu si vendi ku u hartua vepra e parë madhore për historinë e Shqipërisë.

Historia e parë e Shqipërisë është ajo e priftit francez Zhan-Klod Faverial (*Jean-Claude Faveyrial*) dhe u hartua në gjuhën frënge, pikërisht në Manastir, në vitet 1884 deri 1889. Kush ishte autori i kësaj historie të Shqipërisë?

Zhan-Klod Faverial ka lindur më 25 mars 1817 në fshatin Yson-an-Fore (*Usson-en-Forez*) në malet e krahinës Overnjë (*Auvergne*) në perëndim të qytetit Sant Etien (Saint Etienne). Ka kryer studime në Lion (*Lyon*) dhe erdhi në vitin 1843 me moshën njëzetegjashtë në Paris ku hyri në Kongregacionin e Misionit Lazarist dhe ku, dy vite më vonë, u bë prift katolik. Në të njëjten vit, ai u dërgua misionar në ishullin Santorini të Greqisë. Në korrik të vitit 1847, e gjejmë Atin Faverial në Stamboll, ku Kongregacioni kishte një qendër misioni me një rëndësi të veçantë për veprimtaritë e Kishës Katolike në Turqi. Në këtë Qendër e Shën Benediktit (*Maison Saint Benoît*) lindi tek autori një interesim i veçantë për popujt e ndryshme të Rumelisë, d.m.th. të Jugut të Gadishullit Ballkanik. Në vitin 1866, ai u dërgua në Selanik, dhe një vit më vonë, në Manastir. Këto dy qytete ishin qendra të rëndësishme tregtare të Turqisë në Evropë me një popullsi shumë të përzier. Banorët e Rumelisë, siç dihet, ishin jo vetëm turq dhe grekë, por edhe bullgarë, që quhen sot maqedonas në këto vise, si dhe shqiptarë, vllahë dhe romë. Me pak përjashtime, duket se Faveriali kaloi një gjysmë-shekulli në Evropën Juglindore, kryesisht në Manastir.

Që herët në Stamboll, midis viteve 1858 dhe 1867, Faveriali kishte filluar të mbledhte një bibliotekë historike të librave të rralla për shqiptarët, bullgarët dhe vllahët. Ishte një njëri i ditur i cili interesohet shumë për historinë dhe për anekdotat e udhëtarëve, dhe i cili shkruante për çdo gjë që e kishte mesuar. Faveriali interesohet në mënyrë të veçantë për historinë e popujve të jugut të Ballkanit dhe i ndihmoi atë në rrugën e tyre të zhvillimit. Në vitin 1884, ai vizitoi Shqipërinë dhe, bashkë me Apostol Margaritis, themeloi shkolla rumune në Berat, në Korçë dhe në Prizren.

Që nga viti 1859 deri në vitin 1861, thonë se Zhan-Klod Faveriali ishte bërë shpirti i lëvizjes kombëtare bullgare, pra maqedonase. Ishte gjithashtu një mik i madh i shqiptarëve dhe të vllahëve. Nga viti 1867 deri në vdekjen e tij në Manastir në vitin 1893, ai punonte profesor në liceun vllah të Manastirit, ku jepte mësim të gjuhës frënge dhe të filozofisë.

Duket se Zhan-Klod Faverial kishte shkruar shumë, por për fat të keq, ka lënë shumë pak vepra të botuara. Ndër botimet e tij, tani libra tepër të rralla, janë një: *Dorecak i mirësjelljes* bullgarisht (Stamboll 1858), *Dialogë frëngjisht-bullgarisht* (Stamboll 1859) dhe *Katekizmi i madhe për bullgarët uniatë* bullgarisht (Stamboll 1862). Njohim edhe disa artikuj të tij për situatën në Manastir, për gjuhën bullgare dhe për liturgjinë bullgare, si dhe korrespondencën e tij.

Vepra e tij kryesore, Historia e Shqipërisë (*Histoire de l'Albanie*), u botua në origjinalin frëng nga unë në Pejë në vitin 2001 me 426 faqe. Është një vepër kulturore tepër e rëndësishme për popullin shqiptar, duke qenë e para vepra që e jep tërë historinë e këtij vendi që nga koha e lashtë deri në gjysmën e dytë të shekullit nëntëmbëdhjetë. Është vëllimi i pari

kushtuar tërësisht historisë së Shqipërisë.

Shumë botime të tjera të këtij lloji nuk ka nga shekulli nëntëmbëdhjetë. Si krahasim, mund të përmendim vetëm veprën prej katër vëllimësh të Françesko Tajanit *Le istorie albanesi* (Historitë shqiptare) e botuar në Salernë të Italisë në vitin 1886. Dymbëdhjetë vjet më vonë u botua historia e parë e Shqipërisë në gjuhën shqipe: *T'nnolunat e Scýpniis prei gni Gheghet ci don vënnin e vet* (Aleksandria e Egjiptit 1898) nga Stefë Zurani (1865-1941). Në fillim të shekullit njëzet mund të përmendet vepra e rallë prej 416 faqesh *Historia e Shcypniis ch' me fillëse e déri me kohe ku ra ne dore te Turkut* (Bruksel 1902) nga prosatori dhe botuesi i njohur shkodran Ndoc Nikaj (1864-1951).

Historanët perëndimore filluan të interesoheshin për historinë e Shqipërisë vetëm gjatë Luftës së Parë Botërore. Ndër veprat kryesore të historiografisë gjermanisht janë: *Geschichte von Montenegro und Albanien* (Historia e Malit të Zi dhe Shqipërisë, Gotha 1914) nga Spiridion Gopçeviq, dhe *Geschichte Albaniens* (Historia e Shqipërisë, Lajpcig 1914) nga Karl Rot (Karl Roth, lindur 1866). Pak kohë më vonë u botua vepra e parë në gjuhën frënge pas Faverialit, *Brève histoire de l'Albanie et du peuple albanais* (Historia e shkurtër e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar, Bukuresht 1919) nga historiani i madh rumun Nikolaj Jorga (1871-1940), një libër i vogël prej 68 faqesh dhe pa shumë vlerë historike

Gjatë leximit të Historisë së parë së Shqipërisë, pra e asaj të Faverialit, duket se autori nuk kishte një ide të qartë për shqiptarët si komb dhe për Shqipërinë si vend, siç i njohim sot. Historia e tij është më shumë historia e tërë rajonit të Evropës juglindore, duke përfshirë jo vetëm shqiptarët, por edhe vllahët apo aromunët të Pindit, si dhe grekët, turqët dhe sllavët. Kështu, *Historia e Shqipërisë* është historia e gjithë pjesës jugperëndimore të Ballkanit, duke përfshirë Shqipërinë e sotme, Maqedoninë në tërësi, Epirin, dhe Malin e Zi. Lexuesi do të gjejë gjithashtu të dhëna të rëndësishme për historinë e Kishës Katolike në Ballkan dhe, në mënyrë të veçantë, shumë hollësi për historinë e Patriarkatit të Ohrit (1394-1767).

Vlen të theksohet gjithashtu se autori ishte në dijeni për veprat e letërsisë shqiptare ku, në një kapitull të veçantë, ai shkruan për Pjetër Budin, Frang Bardhin dhe Pjetër Bogdanin.

Për saj i përket vlerës historike të librit *Historia e Shqipërisë*, ai me siguri nuk do të plotësojë nevojat e historianit të sotëm të Ballkanit dhe nuk është plotësisht besnik faktëve të historisë siç i njohim sot. Megjithatë, libri i Faverialit është një vepër plot informacioni. Ai përmban shumë hollësi që nuk gjinden në asnjë vepër tjetër.

Arkivi i Kongregacionit të Misionit Lazarist në Paris, ku e gjeta dorëshkrimin e Faverialit, disponon edhe dokumenta të tjera për historinë e Shqipërisë dhe për historinë e Kishës Katolike në trevat shqiptare në fund të shekullit nëntëmbëdhjetë. Është fjala për dokumenta dhe korrespondenca e personave të ndryshme, disa të njohura akoma dhe disa të harruara sot: Prenk Bib Doda Pacha (vdekur më 1920), Davidika Bib Doda, Margela Bib Doda, Dario Bucciarelli (1827-1878), Fulgjenc Carev (Fulgence Czarev, Kryepeshkopi i Shkupit), Preng Doçi (1846-1917), Jean-Pierre Karadaku, François-Xavier Lobry, Andrea Logareci (Andrea Logorezzi, Kryepeshkopi i Shkupit), Simon Lumezi (famulltar i Prizrenit), Anton Bityçi (Antonio Bittucci, famulltar i Shkupit), Michel Tarabulusi dhe Gjergj Çako.

Shumica e dokumentave të këtij arkivi, të cilat gjindeshin fillimisht në liceun e Shën Benediktit në Stamboll, u riatdhesuan për në Paris, por një inventar të saktë nuk ka, duke qenë se shkolla e Stambollit u pushtua nga ushtria turke në vitin 1914 dhe dokumenta të caktuara u zhdukën.

Biblioteka e madhe personale e Faverialit e librave të rralla për popujt e Ballkanit, duket se u dogj gjatë zjarrit i cili shkatërroi qendrën lazariste në Manastir në shkurt të vitit 1909. Për fatin e dorëshkrimeve të tjera të Faverialit, fjala vjen për një *Histori e Vllahërve* (1891), një *Histori i Gadishullit Ilirik* (s.d.) dhe një *Katekizëm vllah për priftërinj* (1891), nuk dihet. Të paktën, Historia e Shqipërisë (*Histoire de l'Albanie*), pra historia e parë e Shqipërisë e shkruar ndonjë herë, u shpëtua.

[botuar në: *Bota Shqiptare*, Romë, 5-18 dhjetor 2003, f. 14, në bazë të një versioni fillestar të mbajtur si ligjeratë në mbledhjen përkujtimore për 95 vjeçarit e Kongresit të Manastirit, në Shkup më 17 nëntor 2003. Published in *Bota Shqiptare*, Rome, 5-18 December 2003, p. 14, on the basis of an original version held on 17 November 2003 as a lecture for a conference in Skopje commemorating the 95th anniversary of the Congress of Manastir.]